



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr. 1768 / Prot.

Gjirokastrë, më 18 / 02 / 2020

Lënda: Dërgim dokumentacioni shtesë.

z. REZANA VRAPI

DREJTORE

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

TIRANË

Në vijim të shkresës nr. 1768 prot, datë 18.12.2019 "Kërkesë për regjistrimin e formës së diplomës të programit me karakter profesional 2 – vjeçar "Librar dhe Biblotekar" dhe në përgjigje të shkresës Tuaj, nr. 6158/1 datë 30.12.2019 "Kthim përgjigje : " Kërkesë për regjistrimin e formave të diplomave", në mbështetje të nenit 11/2 të udhëzimit nr. 25, datë 10.11.2017, "Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", i ndryshuar po ju përcjellim :

a- Dokumentin e pagesës së tarifës për regjistrimin në regjistrin shtetëror, për llogarinë VASHA-së. Gjithashtu në mbështetje të pikës, 2 të nenit 4 të udhëzimit nr. 25, datë 10.11.2017 "Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor" i ndryshuar me udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 1, datë 12.02.2018 po ju përcjellim:


b- Vendimin e Senatit Akademik për miratimin e formës së diplomës për programin profesional "Librar dhe Bibliotekar".

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Konceptoi
Klaviara Dudumi 
Përgjegjëse e sektorit të standarteve dhe kurrikulave

Prof.dr Bektash MEMA

REKTOR



UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
REKTORI

Nr. 1542 / Prot.

Gjirokastrë, më 17. 12. 2020

Lënda: Dërgim informacioni për studentët e regjistruar në vitin akademik 2020 - 2021, në programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor", në programet e studimeve me karakter profesional në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastrë, me qëllim për pajisjen e tyre me numra matrikullimi.

ZNJ. REZANA VRAPI
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
MINISTRË SË ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

TIRANË

E nderuar Znj. Vrap,ë,

Duke ju referuar shkresës nr. 6415 prot., datë 27.11.2020 "Mbi regjistrimet e studentëve për vitin akademik 2020-2021, të administruar pranë Universitetit "Eqrem Çabej" nr.1542 prot, 01.12.2020, dhe duke u mbështetur në urdhërin e përbashkët nr.2, datë 02.07.2020 të QSHA dhe RASH, "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të ciklit të parë, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e integruara të ciklit të dytë dhe në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë 2020 - 2021" dhe urdhërit të përbashkët nr.4, datë 30.09.2020, të QSHA dhe RASH, për një ndryshim në urdhërin e përbashkët nr.2, datë 02.07.2020 të QSHA dhe RASH, "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të ciklit të parë të parë, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e integruara të ciklit të dytë dhe në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë 2020 - 2021", po ju dërgojmë listën e studentëve të regjistruar në programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor", në programet e studimit me karakter profesional, listën e studentëve të ardhur me transferim dhe fakultet të dytë të studimeve bashkëlidhur kësaj shkrese gjenden vendimet e shpalljes së kandidatëve fitues për transferimet e studimeve dhe programet e dyta të studimeve si dhe vërtetimet e ç' regjistrimit nga Universitet që transferohen.

Lista e të regjistruarve në programet e sipër cituara për vitin akademik 2020 - 2021, po ju përcillet në formatin excel në CD bashkëlidhur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin!

REKTOR

Prof. Dr. Bektash MEMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
DREJTORIA E SHËRBIMEVE NDIHMËS AKADEMIKE – ADMINISTRATIVE
SEKTORI I STANDARTEVE DHE I KURRIKULAVE

Nr. 1643 Prot.

Gjirokastër, më 21 / 12 / 2020

Lënda: Dërgim informacioni për studentët e regjistruar në vitin akademik 2020 -2021 , në programet e studimit të ciklit të dytë "Master" , "Master Profesional" dhe "Master i Shkencave" në Universitetin "Eqrem Çabej", me qëllim pajisjen e tyre me numër matricullimi .

znj. REZANA VRAPI
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

TIRANË

E nderuar znj. Vrap!

Në zbatim të udhëzimit nr. 25, datë 01.12.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 15.05.2019 " Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë , i ndryshuar" pika 1 / e, urdhërit të përbashkët nr. 2, datë 02.07.2020 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e integruara në ciklit të dytë dhe në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2020 -2021" të QSHA- së dhe RASH-it , urdhërit nr. 4, datë 30.09.2020, për një ndryshim në urdhërin e përbashkët nr. 2 , datë 02.07.2020 "Për miratimin e kalendarit për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimit të ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e integruara në ciklit të dytë dhe në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2020 -2021",



po ju pëcjellim në formatin excel (në CD) bashkëgjitur kësaj shkrese , listën e të regjistruarve në programet e studimit të ciklit të dytë “Master”, “Master Profesional” dhe “Master i Shkencave” , për vitin 2020-2021, që ofron universiteti “Eqrem Çabej”, me qëllim pajisjen e tyre me numër matrikullimi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Prof.dr Bektash MEMA

REKTOR

(Në mungesë dhe me porosi)

Prof.asoc Jaho CANA

Zv/REKTOR për prokurim dhe marrëdhënie



Konceptoi / punoi: Klaviona Dudumi

Pranoi: Violeta Serjani

Konfirmoi / Miratoi : Prof.asoc Jaho Cana





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr 1349 Prot.

Gjirokastër, më 24/10/2018


Lënda: Lista e regjistrimeve përfundimtare të raundit të tretë dhe kuotave të lira për Universitetin "Eqrem Çabej".

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
MINISTRIA E ARSIMIT SPORTIT DHE RINISË

TIRANË

Në zbatim të udhëzimit nr. 18 datë 21.05.2018 "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë" për vitin akademik 2018-2019", Raundi i tretë i aplikimeve, Kreu IV pika 6, po ju përcjellim listat e regjistrimeve përfundimtare për këtë raund në të gjitha programet e studimit të ciklit të parë dhe programeve me karakter profesional që ofron Universiteti "Eqrem Çabej" Gjiroakstër.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

REKTOR

Prof. Dr. Bektash MEMA




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr. 1768 Prot.

Gjirokastër, më 18 / 12 /2019

Lënda: Kërkesë për regjistrimin e formës së diplomës të programit me karakter profesional 2 – vjeçar
“Librar dhe Biblotekar”.

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

T I R A N Ë

Në zbatim të urdhërit nr. 403, datë 25. 07. 2019, të MASR-së dhe vendimit nr 27, datë 21.11.2018. të Senatit Akademik , “ Për hapjen e programit të studimit me karakter profesional në : “ **Librar dhe Biblotekar**”, që realizohet me 120 kredite, në gjuhën shqipe, me kohë të plotë dhe kohëzgjatje normale 2 vite akademike (4 semestra) në Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore në Universitetin “Eqrem Çabej” kërkojmë nga ana juaj ;

Regjistrimin e formës së diplomës “Diplomë Profesionale” në Universitetin “Eqrem Çabej” si mëposhtë:

Diplomë Profesionale në “Librar dhe Biblotekar”

